STS-PSA-INFO

SCHWEIZER TIERSCHUTZ STS · PROTECTION SUISSE DES ANIMAUX PSA · PROTEZIONE SVIZZERA DEGLI ANIMALI PSA

Schildkröten / Tortues / Testuggine
Albanisch / Albanais / Albanese

Fletë udhëzuese mbajtja e breshkave

Jeta mesatare: Breshkat tokësore mund të jetojnë mbi 100 vite, breshkat e detit (apo ujore) mund të arrijnë 80 vite. Pra përkujdesja për breshkat e ujit është një detyrë me kohëzgjatje, bile një detyrë jetësore!

Shpenzimet

Kafsha	100-250 CHF	Varësisht nga lloji dhe mosha
Shpenzimet fillestare	1000-10 000 CHF	Gardhë të përshtatshëm për llojin në kopsht ose në terrarium brenda, pajisje, teknikë terraristike (llambë ngrohëse, llambë ultraviolete, pompë të ujit, orë me ndërprerës,...)
Shpenzimet vjetore	përafërsisht 500 CHF	Ushqim, shpenzimet për veterinerin, qëndrim në pansione për kafshë gjatë pushimeve ose përkujdesje shtëpiak, kalimi i dimrit
Të tjera	Shpenzimet e jashtëzakonshme të veterinerit mund ta tejkalojnë shumë çmimin e blerjes së kafshës.	

Kafshë delikate

Para vendimmarrjes për një breshkë, mbajtësit e ardhshëm të breshkave duhet të informohen thellësisht tek specialistët dhe me anë të literaturës së lëmisë. Një mbajtje e gabuar çon deri tek vuajtja shumëvjeçare dhe vdekja e ngadalshme – profani i vëren shpesh shumë vonë problemet shëndetësore të breshkave të veta! Breshkat nuk janë kafshë të thjeshta shtëpiake, përveç kësaj mbajtja e breshkave në establimentet e përshtatshme për llojin është e kushtueshme.

Adhurues të diellit

Breshkat kanë nevojë për rrezatim ultraviolet nga drita e diellit, për një rritje të shëndosh të guallit (shtëpizës/mburojës) dhe për nxehtësi, në mënyrë që të bëhen aktive si kafshë që ndryshojnë temperaturen e trupit sipas mjedisit.

Llojet e breshkave

Vetëm pronarët e kopshteve mund t´ju ofrojnë breshkave një hapësirë të volitshme jetike për kafshë, me shumë ajër të freskët dhe diell. Edhe breshkat e vogla rriten shpejt deri në një madhësi, e cila bën të pamundshëm mbajtjen në terrarium të brendshëm, dhe bën të domosdoshme shpërnguljen për në kopsht.

Ku të blihen?

Kafshërritësit e përgjegjshëm kafshët e veta i marrin ose nga një shtëpi strehimi të kafshëve, e cila mbahet nga një shoqatë lokale mbrojtëse të kafshëve, nga një stacion për mbledhjen e breshkave ose prej një kafshërritësi të mbarështimit zviceran. Atje

garantohet edhe një këshillim i besueshëm. Në asnjë mënyrë nuk duhet të blehen breshkat thjeshtë në treqet e vendeve jugore. Në shumë raste këtu behët fjalë për llojet e mbrojtura të kafshëve, të cilat pa miratimin e Komisionit për Mbrojtjen e Llojeve CITES (Artenschutzkommision) dhe të Entit Federale për çështje veterinare në Zvicër BVET (Bundesamt für Veterinärwesen) nuk bën të importohen në Zvicër. Përmes një blerje të tillë të breshkave të përkrahet shfrytëzimi ekstensiv i popullimit të breshkave të rrezikuara, të cilat jetojnë të lira. Edhe për llojet e pambrojtura si breshka faqekuqe duhet një miratim paraprak nga BVET, për të pasur të drejtën e kalimit të kufirit. Për mbajtjen e një lloji më të madhë/ më të rritur të një breshke është e nevojshme një leje për mbajtjen e Entit kantonal të veterinës.
Hiqni dorë nga blerja e kafshëve përmes internetit! Kafshët e ofruara përmes internetit kanë shpesh origjinën e tyre nga prodhimet masive dhe rriten nën kushte të tmerrshme të mbajtjes. Gjithashtu edhe tregtia ilegale me kafshë zhvillohet shpesh përmes shpalljeve falas në internet, dhe po ashtu janë prezent edhe mashtrimet.

Çfarë ju nevojitet breshkave të tokës?

Mbajtja e breshkave greke të tokës në formë të përshtatshme për kafshë është e mundshme vetëm në raste të mbajtjes verore në livadhe të hapura, në një kopsht të përshtatshëm për breshka. Kush nuk ka mundësi për këtë, duhet të heq dorë nga mbajtja. Hapësira e breshkave duhet të jetë mundësisht e rrezatuar me shumë diell, por të ketë edhe vende me hije. Ajo duhet të rrethohet me pahi të drurit ose me një mur të ulët: breshkat mund të ngjiten dhe gërmojnë mirë.
Bazamenti duhet të jetë i ndryshëm dhe të ketë gurë, rrënjë, kaçuba, dhe mundësi për tu fshehur. Breshkat greke të tokës janë vegjetariane. Ato duhet të ushqehen me barishte, bimë dhe sanë fijore. Frutat mund të shkaktojnë probleme në tretje, nuk duhet të ushqehen me mish dhe produkte mishi, sepse ato çojnë deri te rritja e tepërt dhe pashëndetshme të mburojës!

Çka ju nevojitet breshkave të ujit?

Breshkat e njohura faqekuqe duhet të mbahen në kopshtet me pellg dhe të sigurta kundër shpërthimit (ikjes). Pellgu duhet të jetë shumë i madh (disa metra katror) dhe shumë i thellë (më shumë se 1 m), të ketë edhe vende të thella edhe të cekëta, si dhe të disponon një filtrim efikas. Megjithatë shpesh duhet të ndërrohet një pjesë e ujit, që të mbahet pellgu i pastër, ngase breshkat prodhojnë shumë mbeturina. Ndërsa breshkat e reja mbahen brenda në një akuaterrarium të madh. Ato kanë nevojë për shumë vend për notim (thellësia e ujit së paku dy gjatësi mburojës), ishull qetësie të ngjitshëm, vende për tu rrezitur dhe gjithmonë për ujë të pastër. Breshkat faqekuqe duhet të mbahen në grupet e gjinisë së njëjtë, se meshkujt ju bien shumë në qafë femrave. Kafshët e reja marrin kryesisht ushqim shtazorë, breshkat faqekuqe kanë më shumë nevojë, me rritjen e moshës, për një pjesë gjithnjë e më të madhe të ushqimit bimorë (sallata, lule qumështore).

Gjumë dimëror (letargjia)

Shumë lloje të breshkave mbajnë një gjumë dimëror (pushim letargjikë). Dimërimi korrekt nuk është i thjeshtë, dhe ekzistojnë metoda të ndryshme (arkë me gjethe dhe dheu në bodrum, sirtar i frigoriferit me ajrosje të rregulluar, gropë e thellë në kopsht). Prandaj duhet patjetër t´ju përmbahet rekomandimeve të specialistëve, për shembull këshillave të atyre, prej të cilëve janë blerë kafshët dhe të atyre të bashkësisë së interesave të breshkave në Zvicër („Schildkröten-Interessengemeinschaft Schweiz“). Edhe kafshët e reja duhet të bëjnë një gjumë dimëror, por kafshët e sëmura jo.

Shumimi

Duhet hequr dorë nga shumimi i kafshëve, ngaqë vendosja e kafshëve të reja në vendet vërtet të volitshme për jetën e kafshëve është jashtëzakonisht e vështirë, përveç kësaj një numër i mjaftueshëm i këtyre kafshëve jetëgjata presin në shtëpitë strehimore për kafshë, në stacionet mbledhëse të kafshëve dhe tek rritësit për vende të mira.

Breshkat dhe pushimet

Breshkët rrinë më së miri në shtëpi, në gardhin e tyre gjegjësisht në terrarium, ushqehen dhe mirëmbahen prej një personi të specializuar dhe të besueshëm. Ato mund të strehohen si alternativë në një pension për kafshë ose në një shtëpi për kujdesen e kafshëve të braktisura, që kushton 10-20 franga në ditë. Lëshimi i kafshëve në rrugë është e ndaluar me ligj dhe mund të ndëshkohet me një gjobë deri në 20 000 franga.

Breshkat dhe fëmijët

Breshkat e mbajtura sipas llojit përkatës ofrojnë mundësi tepër tërheqëse vrojtimi. Megjithatë breshkat nuk janë as kafshë ledhatuese e as lodra, por kafshë, të cilat kërkojnë kujdes shumë kërkueshëm . Një i rritur duhet ta merr përgjegjësinë, ti udhëzon dhe mbikëqyr fëmijët në përkujdesje të kafshëve. Fëmijët edhe nga arsyet financiare nuk mundë të kujdesen për breshkat, madje është e paqartë, nëse ata, varësisht nga zhvillimi profesional, a do të kenë më vonë realishtë kohë për kafshët. Prandaj preferohet, që dëshira për breshkë të diskutohet hollësisht përbrenda familjes si dhe të konsultohen specialistët.

Informacionet dhe vendet për kontakt

- „Schildkröten als Heimtiere?“ (Breshkat sie kafshë shtëpiake), „Rotwangen-Schmuckschildkröte“ (Breshka faqekuqe), „Griechische Landschildkröte“ (Breshka greke e tokës) (gjermanisht), fletë udhëzuese Mbrojtja Zvicerane e Kafshëve STS, Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, kutia postare, 4008 Basel, Tel. 061 365 99 99, Faksi: 061 365 99 90, www.tierschutz.com, sts@tierschutz.com, këshillim falas (në gjermanisht, frëngjishte, anglisht), broshura falas, adresar e vendstrehimeve për kafshë, klubi i fëmijëve www.krax.ch
- Protecion et Pecuperation des Tortues PRT, organizatë e specializuar për mbrojtjen e breshkave, Grand Paquier, 1373 Chavornay, tel. 024 441 86 46 (vetëm në frëngjishte), www.tortue.ch, këshillim falas, pranimi dhe vendosja e breshkave, nga të cilat hiqet dorë dhe për breshkat e gjetura.
- „Die Rotwangen-Schmuckschildkröte“ (breshkët faqekuqe), „Bau einer Folienteichanlage zur Haltung von Sumpf- und Wasserschildkröten“ (ndërtimi i një pellgu me plasmas (folie) për mbajtjen e breshkave të ujit dhe të kënetës), „Die griechische Landschildkröte“ (breshka greke e tokës) , „Winterschlaf europäischer Landschildkröten“ (gjumi dimëror i breshkave evropiane të tokës), „Freilandanlage für Europäische Landschildkröten“ (livadhe të hapura për breshkën evropiane të tokës) (gjermanisht), fletë udhëzuese të bashkësisë së interesave të breshkave në Zvicër SIGS (Schildkröten-Interessengemeinschaft Schweiz SIGS).
  Schildkröten-Interessengemeinschaft SIGS, Postfach, 4416 Bubendorf, www.sigs.ch, info@sigs.ch, telefon këshillimi 079 432 76 32, këshillim falas, stacionet mbledhëse.

Redaktor:
Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, 4008 Basel,
Tel. 061 365 99 99, Fax 061 365 99 90, www.tierschutz.com, sts@tierschutz.com